



Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/23 Nr. ifaq/Br.str/No.pg 31

Data/Date/VDate 28.02.2023

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 1 dhe 2, shkronja (d), nenit 14, nenit 17, paragrafi 1, shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr-03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 10, paragrafi 1 dhe 2, pika 2.4, nenit 39, nenit 40, nenit 57, paragrafi 1, pika 1.3 dhe nenit 94, të Statutit të Komunës së Rahovecit, me Nr. Prot. 1005, të datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 28.02.2023, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e komunitetit të fshatit Kramovik

1. Me këtë vendim **caktohet** lokacioni për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e komunitetit të fshatit Kramovik.
2. Lokacioni i cekur në pikën 1, të këtij vendimi, do të jetë në pjesën e parcelës kadastrale sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510039-00330-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej 7768m² (shtatë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë metra katror), zona kadastrale Kramovik, e evidentuar në posedim të PRONA SHOQËRORE- PALUAJTSHMËRIA; K.K.Rahovec.
3. Nga sipërfaqja e përgjithshme e parcelës së cekur në nenin 2 të këtij vendimi, ndahen 400m² (katërqind metra katror) për ndërtimin e objektit, për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme, për nevojat e komunitetit të fshatit Kramovik.
4. Pjesa e parcelës në sipërfaqe prej 400m² (katërqind metra katror) në të cilën parashihet të ndërtohet objekti për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e komunitetit të fshatit Kramovik, sipas pikës 2 dhe 3 të këtij vendimi, sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 01 Nr. 2566, i datës 30.5.2013, gjendet brenda zonës ndërtimore.
5. Objekti për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e komunitetit të fshatit, do të financohet nga donatorët.
6. Prona e paluajtshme dhe objekti që do të ndërtohet, nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë nga donatorët e ndërtimit të objektit.
7. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, në Komunën e Rahovecit, që të bëjë parcelizimin dhe skicimin në terren dhe regjistrimin e gjendjes në librat kadastralë.

8. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
9. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb- faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Kryetarit të Komunës,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS RAHOVEC

01-Nr.31/23
Me datë:28.02.2023

